



REPUBLIKA E KOSOVËS  
 REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO  
 KOMUNA E GJAKOVËS  
 OPŠTINA DJAKOVICA / MUNICIPALITY OF GJAKOVA



**Kuvendi i Komunës së Gjakovës**

01 Nr. \_\_\_\_\_ /2024

Datë: 30.05.2024

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 12 Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenit 11 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës, si dhe nenin 23 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës, në mbledhjen e mbajtur me datë 30.05.2024 pas diskutimit në pikën e 6 të rendit të ditës: Propozim Vendimi për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të Pronës së paluajtshme Komunale me numër kadastral P-70705029-00468-23, Z.K Gjakovë-Qytet, e miratoi këtë:

**V E N D I M**

1. Miratohet Propozim Vendimi i Kryetarit të Komunës për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme komunale me numër kadastral P-70705029-00468-23 Z.K Gjakovë-Qytet, e evidentuar në Pronësi të Komunës së Gjakovës, sipas marrëveshjes së negociimit në mes të Komunës së Gjakovës dhe "Jeton Bakalli" B.I, me numër 01-463/01-7892, të datës 22.05.2024 .
2. Afati kohor për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale sipas pikës 1 të këtij vendimi është afatgjatë, përkatësisht 99 vite.
3. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës është interesi publik, përfitimi ekonomik i Komunës nga prona komunale, si dhe funksionalizimi i pronës komunale në bazë të Hartës Zonale të Komunës së Gjakovës .
4. Mënyra, kushtet dhe kompensimi i shfrytëzimit të pronës së paluajtshme të Komunës, do të përcaktohen në kontratë sipas marrëveshjes së negociimit në mes të Komunës së Gjakovës dhe "Jeton Bakalli" B.I, me numër 01-463/01-7892, të datës 22.05.2024.
5. Pjesë përbërëse e vendimit janë: Kërkesat e palës, Marrëveshja e negociimit në mes Komunës të Gjakovës dhe "Jeton Bakalli" B.I, Projekti i paraqitur nga investitori dhe plani dinamik i realizimit të investimit, Plani i investimit-paramasa dhe paralogaria, Certifikata e pronësisë dhe kopja e planit, Certifikata e regjistrimit të biznesit, Vërtetimi që nuk ka obligime tatimore, si dhe qarkullimi bankar për vitin paraprak i biznesit "Jeton Bakalli" B.I.
6. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës .

**7. Vendimi iu dërgohet:**

- Kryetarit të Komunës së Gjakovës z. Ardian Gjini
- Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal
- Drejtorisë për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë .
- Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit .
- Shërbimit profesional të Kuvendit të Komunës
- Arkivit



Kryesuesja e Kuvendit të Komunës